

09/02/2022.

Akt Themelimi

I shoqerise “ ÇELA GROUP ” SHPK

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise , ne ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 “ Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private , nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit” , te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 , “ Per shoqerite tregtare” dhe te ligjit Nr.9723 , date 03.05.2007 . Per Q.K.B dhe formalitetet qe duhe respektuar nga Shoqerite Tregtare , me vullnetin e tone te lire , te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi une ortaku i vetem :

Vendosa te krijoj shoqerine “ ÇELA GROUP SHPK ” , me akt themelimi si vijon

Formulimi

Neni 1

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur “ ÇELA GROUP SHPK ” . Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar , ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega . Shoqeria do te ushtrje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortakët themelues .

Selia e Shoqerise

Neni 2

Selia e shoqerise “ ÇELA GROUP SHPK ” eshte Lagja Haxhias ,pasuria nr.3/197-ND zona kadastrale nr.8525, rruga Sabaudin Bahja , ndertesa nr .67 kati i pare Elbasan

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj , te hape zyra perfaqesie , dege , te krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise , vetem me vendim te asamblese dhe ortakeve .

Objektivi I Veprimtarise

Neni 3

Objekt I veprimtarise do te jete : Sherbime ndertimi dhe restaurimi. Import Eksport

Kohezgjatja e Shoqerise

Neni 4

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar . Ajo mund shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkakut .

Kapitali I Shoqerise

Neni 5

Kapitali fillestar i shoqerise private “ ÇELA GROUP ” eshte 100.000 (njeqindmije) leke shqiptare .

-Z. Pullumb Cela eshte ortak i vetem me 1 (nje) kuote me vlere nominale 100.000 leke. Kapitali themeltar fillestar mund te shtohet ose paksohet por jo nen vleren e kapitalit themeltar fillestar.

Neni 6**Drejtimi I Shoqerise**

Shoqeria do te drejtohet nga administratori e saj , Z. Pullumb Cela nje afat kohor 5 vjecar . Ai eshte perfaqesuese e Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e tij . Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues I pajisur me prokure te posacme .

Neni 7

Te ardhurat neto te shoqerise I takojne ortakut te vetem .

Neni 8

Ortaku ka te drejte te emeroje dhe administrator tjerer te vlerave materiale
Ka te drejte te caktoje financiere , likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtoje persona te tjere si ortake .

Neni 9

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqipetar ne Gjykatën e Rethit Gjyqesor Elbasan

Neni 10

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme , me tekstin rreth saj .

Neni 11

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqipetar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Krijimin e Shoqerive Tregtare" , si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjom shoqeri .

Neni 12

Akti I themelimit u perpilua ne 2 kopje , per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise .

Akti I themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortakut i vetem i shoqerise :

Ortaku i Vetem**Pullumb Cela**